L I G J
Nr.7873, datë 16.11.1994

PËR SEKUESTRIMIN E MJETEVE TOKËSORE, DETARE E AJRORE, ME TË CILAT KRYHEN VEPRA PENALE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Sekuestrohen mjetet tokësore, detare e ajrore nga organet e Ministrisë së Rendit Publik, në rastet kur:

a) Me dijeninë e pronarit vihen në shërbim ose përdorim:

1. Si mjet për kryerjen e një krimi.
2. Për të transportuar armë, drogë, lëndë narkotike e radioaktive.
3. Për të transportuar klandestinë.
4. Për të transportuar mallra të vjedhura.

b) Janë:

1. Si të vjedhura ose të tjetërsuara me dokumente false.
2. Me targë, kontratë sigurimi, taksë regjistrimi dhe dokument zhdoganimi të falsifikuar dhe me patentë të falsifikuar nga pronari i mjetit.
3. Me numër shasie të modifikuar ose ndryshe nga ai i shënuar në lejen përkatëse.

Sekuestrohen armët e zjarrit e të gjahut dhe municionet e tyre, armët dhe municionet paralizuese që janë futur në Shqipëri jashtë pikave doganore ose me dokumente të falsifikuara.

Neni 2

Vendimi i sekuestrimit merret nga shefi i Komisariatit të Policisë së rrethit përkatës, mbi bazën e propozimit të komisionit që ngrihen në çdo komisariat me urdhër të ministrit të Rendit Publik. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e rrethit.

Neni 3

Automjetet, motoçikletat, anijet, motoskafët dhe armët e zjarrit të sekuestruara i kalojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës së Shtetit, sipas rregullave e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.961, datë 22.11.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.